



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.113 dt.28.09.2001

**MBI
FINANCIMIN E PROJEKTEVE TE BASHKISE TIRANE ME FONDIN E
ZHVILLIMIT SHQIPETAR**

Në mbështetje të nenit 32 gërma “dh” të Ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.218 dt.24.12.1999 “Për miratim fondi për kontributin e Bashkisë në programin “Përmirësimi i Tiranës”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.22 dt.13.02.2001 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2001”, kontratave të lidhura midis Bashkisë Tiranë në rolin e përfutësit dhe F.ZH.SH-së, respektivisht për objektet: Kodi WS 122.TR.13.U, Kodi UI.134.TR.14u, UI.135.TR.15.U Kodi UI.136.TR.16.U, Kodi RO.137.TR.17.U, Kodi RO.138.TR.18.U, Kodi RO.139.TR.19.U, Kodi RO.140.TR.20.U, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I

1. Të miratohet shumën prej 5.000.000 (pesë milion) lekësh në favor të Fondit të Zhvillimit Shqiptar për përballimin e kontributit të prapambetur prej 10% (përfshirë dhe vlerën e TVSH-së) sipas kontratave të lidhura
2. Shuma prej 5.000.000 lekësh të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë, duke pakësuar Zërin “Pajisje specifike për matje topografike...”
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Urban, Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore

dhe Informacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve
Ekonomike

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA

